



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 674117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike në nivelin institucional për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2022.
- II. Riakreditohet programi i studimit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Siguri Publike, BA, 240 ECTS, (me specializime: Policor; Doganor; Korrektues dhe Sprovues; Menaxhimi Emergjent), maksimumi 65 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim institucional dhe ri/akreditim të programit të studimit: Siguri Publike, BA, 240 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Siguri Publike	BA	240	Bejtush Gashi, Besnik Fetahu, dhe Nexhat Jashari

AKA ka organizuar vizitën në Akademia e Kosovës për Siguri Publike më 12.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Reinhard Meyers, Hans-Joachim Giessmann, dhe Rebecca Maxwell Stuart.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Akademia e Kosovës për Siguri Publike, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

